



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:060457

Datë: 26.07.2024

Numri i dokumentit: 05989225

KE.nr.2877/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit N.T.SH. “Gekos” SH.P.K., me seli në Rr. “Rrafshi i Kosovës”, Lagjja Veternik në Prishtinë, me NRB: 80191014, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Daut Rudi, avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurit Ipko Telecommunications L.L.C., me seli në rrugën Zija Shemsiu, nr.34, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 396,062.26 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 11.07.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.SH. “Gekos” SH.P.K., dhe DETYROHET i padituri Ipko Telecommunications L.L.C., që në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të humbur, të shkaktuar si pasojë e shkëputjes së njëanshme të kontratës “Master distributor” të datës 10.12.2007, të i’u paguaj paditësit shumën prej 76,805.87 €, (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesë euro e tetëdhjetë e shtatë cent), me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në Bankat Komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 14.06.2013, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.T.SH. “Gekos” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Ipko Telecommunications L.L.C., që në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të humbur të shkaktuar si pasojë e shkëputjes së njëanshme të kontratës “Master distributor” të datës 10.12.2007,

të ia paguaj paditësit shumën prej 319,256.39 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi 1 vit pa destinim të caktuar nga data 01.07.2010 e deri me datën 30.11.2012, kurse prej datës 30.11.2012 e deri në pagesën përfundimtare sipas kamatës prej 8% në vit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi

III. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 3,764.20 € (tremijë e shtatëqind e gjashtë dhjetë e katër euro e njëzet cent), në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.SH. "Gekos" SH.P.K., me datën 14.06.2013, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkëputje të një anshme të kontratës, kundër të paditurit Ipko Telecommunications L.L.C., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit të ia paguaj shumën prej 478,800.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me datën 11.03.2016 paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit të ia kompensoj dëmin në emër të fitimit të humbur në shumën prej 396,062.26 €, me kamatë dhe atë nga dita e ndërprerjes së kontratës 01.07.2010, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi 1 vit pa destinim të caktuar deri me datën 30.11.2012, kurse prej datës 30.11.2012 e deri në pagesën përfundimtare sipas kamatës prej 8% në vit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin C.nr 305/2013 të datës 24.10.2016, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit për shkak të shkëputjes së njëanshme të kontratës të lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse të datës 10.12.2007, e cila ka të bëjë me pretendimin e palës paditëse për kompensimin e dëmit për shkak të fitimit të humbur në shumën e përgjithshme prej 396.062.26, të gjitha këto në afat kohor prej 7 (shtatë) ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,184.00 €, ti paguaj palës paditëse në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse, me Aktvendimin Ae.nr. 287/2016 të datës 09.01.2018, e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka prishur Aktgjykimin C.nr.305/2013 të datës 24.10.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe të njëjtën çështje ia ka kthyer përsëri të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në rivendosje me Aktgjykimin EK.nr 13/2018 të datës 24.10.2018, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit lidhur me shkëputjen e njëanshme të kontratës t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 396,026.00 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuar në bankat komerciale të Kosovës, në periudhe kohore prej një viti duke filluar nga data e shkëputjes së njëanshme të kontratës të datës 01.07.2010 e deri me datën 31.12.2012, ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës llogaritjen e kamatës ligjore prej 8% e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën II të dispozitivit është detyruar pala paditëse që ti paguaj palës së paditur shumën prej 1,724.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në afat prej 7 (shtatë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin me përmbarimit me detyrim.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur, në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse, me Aktvendimin Ae.nr. 292/18 të datës 27.05.2022, e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka prishur Aktgjykimin EK.nr 13/18 të datës 24.10.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe të njëjtën çështje ia ka kthyer përsëri të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i paditësit në referatin e padisë, ka deklaruar që palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratën me master distributor, objekt i të cilës kontratë ka qenë shitja e produkteve për dhe në llogari të paditurës nga ana e paditësit i cili ka pasur të drejtën ekskluzive për shitjen e këtyre produkteve, për një periudhë tre vjeçare e cila automatikisht do të vazhdohej edhe për një afat tre vjeçar nëse gjatë periudhës deri nëntëdhjetë ditë para kalimit të afatit, palët nuk do të dërgonin vërejtje me shkrim për ndryshimin e kontratës. Ka shtuar që kjo kontratë është vazhduar edhe për një periudhë tre vjeçare konform nenit 7 të kontratës, ndërsa e paditura përkundër përcaktimeve të çmimeve dhe njohjes së të drejtës së ekskluzivitetit të paditësit, përmes dilerëve

të saj dhe distributorëve të tjerë ka ndikuar drejtpërdrejt në çmime dhe shitjen e produkteve dhe se e njëjta përkundër faktit që është paralajmëruar nga paditësi disa herë, nuk ka ndërmarr asnjë veprim për parandalimin e veprimeve konkurruese duke ia pamundësuar paditësit realizimin e shitjes sipas parametrave të caktuara.

Më tutje paditësi ka theksuar që edhe përkundër korrespondencave ndërmjet palëve, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të paraqitura, e paditura në mënyrë të njëanshme, sipas vendimit nr. 152 të datës 01.07.2010, e ka njoftuar paditësin se e ka ndërprerë kontratën, me arsyetimin se kinse gjatë gashtë muajve të parë të vitit 2010 paditësi ka bërë blerje gjegjësisht furnizim shumë të ulët, në krahasim me periudhën e njëjtë për vitet e kaluara dhe se me këto shitje të ulta është dëmtuar rëndë e paditura, ndërsa paditësi me qëllim të përmbushjes së obligimeve kontraktuese ka bërë investime të konsiderueshme duke blerë automjete për shpërndarjen e produkteve si dhe ka punësuar staf me qëllimin e vetëm të shitjes sa më të mirë të produkteve në pikat e caktuara sipas nenit 1.3 të kontratës.

Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, paditësi ka mbetur pranë të gjitha deklarimeve, duke theksuar që e paditura në kundërshtim me dispozitat kontraktuese dhe dispozitat ligjore të LMD-së, e ka shkëputur kontratën ndërmjet palëve, pasi që shkëputja është bërë në kundërshtim me nenin 1.3. të Shtojcës 1 të Kontratës, pasi që i padituri të drejtën e shkëputjes së kontratës pa paralajmërim e ka pasur vetëm në rast se paditësi ka bërë shitje dhe shpërndarje të produkteve në lokacionet për të cilat nuk ka pasur autorizim përkatës nga IPKO, ndërsa në rastin konkret edhe nga vet arsyetimi i vendimit për shkëputje të kontratës rezulton se i padituri me asnjë fjale nuk ka potencuar se shkelja është bërë për këtë shkak, e po ashtu nga provat e administruara nuk ka asnjë dëshmi që i padituri i ka dërguar vërejtje paditësit për çfarëdo arsye për ti dhënë shkak ndërprerjes së kontratës, pa paralajmërim dhe në mënyrë të njëanshme në kundërshtim me dispozitat kontraktuese vetëm ka shkëputur kontratën.

Më tutje ka theksuar që i padituri ka pasur obligim kontraktues që në zonat ku paditësi ka shtrirje të rrjetit tregtar, t'ia respektoj ekskluzivitetin dhe t'i parandaloj stërshitësit tjerë, e që nga korrespondenca elektronike (emailat) por edhe nga ekspertiza financiare është konstatuar se i padituri nuk ka vepruar konform obligimeve kontraktuale edhe pse ka pasur njohuri dhe e ka pranuar nga emailat e datës 28.07.2009 dhe 23.09.2009, se në tregun ekskluziv të paditësit ka stërshitës të produkteve të saja si dhe nuk ka ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e stërshitësve, ku si pasojë edhe ka ardhur deri tek pamundësia e mos përmbushjes së obligimeve

kontraktuese, e për të cilat konform nenit 138 të LMD-së, përgjegjëse është pala e paditur. Në fund ka theksuar që është e padiskutueshme ekzistimi i lidhjes kauzale në mes të shkakut, respektivisht veprimeve dhe mosveprimeve të paditurit dhe shkaktimit të pasojave për paditësin, përkatësisht dëmin e shkaktuar dhe pamundësimin e fitimit të pritur për tu realizuar sipas Kontratës, e cila ka mbetur në fuqi në mënyrë automatike edhe për 3 vitet tjera.

I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në shumën prej 5,515,00 €.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka deklaruar që në bazë të provave të administruara, respektivisht sipas kontratës me master distributor të datës 10.12.2007 është vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme fakti se paditësi ka dështuar që të përmbush obligimet kontraktuale të përcaktuara në të njëjtën kontratë, përmes të cilës ka marr përsipër që të furnizoj me produkte të IPKO-së, dy mijë e gjashtëqind pika të shitjes, sipas nenit 1.3 të kontratës në mënyrë të vetme/ekskluzive. Ka theksuar që paditësi gjatë vitit 2008 ka bërë shitje në vlerë prej 5,777.470.75 €, gjatë vitit 2009 ka bërë shitje në vlerë prej 10,460.122.30 €, ndërsa në vitin 2010 ka blerë produkte nga i padituri me qëllimin për ti furnizuar pikat e shitjes në fjalë vetëm në vlerën prej 702,375.00 €, me ç'rast, ka pasur ulje drastike të shitjes së produkteve të paditurit, gjë e cila dëshmon mungesën e përpjekjes nga ana e paditësit për përmbushjen e kontratës.

Ka shtuar që veprimet e paditësit e kanë dëmtuar rëndë të paditurin dhe e kanë detyruar që të bëj ndërprerjen e kontratës, ndërsa në bazë të provave rezulton se është vërtetuar fakti që kontrata ishte lidhur për periudhën prej tri (3) viteve e cila do të mund të vazhdohej edhe për një periudhe 3 vjeçare, nëse palët 3 muaj para skadimit të afatit tre vjeçar nuk do të paraqitnin vërejtje për të njëjtën. Mirëpo, në rastin konkret e paditura e ka ndërprerë kontratën 5 muaj para skadimit të saj, duke e njoftuar për këtë paditësin në mënyre adekuate, si pasojë e faktit që paditësi ka dështuar që të i përmbush obligimet e tij kontraktuale, përkatësisht furnizimin e rregullt të pikave të shitjes me produkte të Ipko-së, ku paditësi në asnjë moment nuk e ka kundërshtuar vendimin e të paditurës për ndërprerjen e Kontratës.

Më tutje i padituri ka deklaruar që pikërisht natyra e kontratës, i ka dhënë paditësit të drejta ekskluzive për ti furnizuar me produkte të IPKO-së, në pikat e shitjes në rrjetin e tij, e të

cilat kanë përfshirë hiper-markete, super-markete, mini-markete, pompa të benzinës dhe kiosqe, për tërë territorin e Kosovës, ndërsa pamundësia e të paditurit për ti shitur produktet e veta në këto pika të shitjes edhe përkundër dështimit të paditësit për furnizimin e të njëjtave me produkte të të paditurit, ka rezultuar me rënien drastike të shitjes duke e detyruar të paditurin që të ndërpres kontratën dhe të gjej mënyra alternative për furnizim të këtyre pikave.

Sa i përket bazës juridike të padisë, i padituri ka theksuar që një gjë e tillë nuk është vërtetuar nga provat e administruara dhe përkundër sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, eksperti financiar nuk ka mundur të bëjë ekzaminimin financiar të të paditurës dhe i njëjti ekspertizën si dhe plotësimin e saj, e ka bazuar në supozime. Kjo pasi që mendimi i ekspertit është edhe kundërthënës, sepse në njërën anë ka theksuar që për të vërtetuar faktin se a ka pasur anashkalim, i janë dashur librat e shitjes për vitin 2009 dhe 2010, ndërkaq në anën tjetër ka dhënë mendimin me nënkuptime, duke u bazuar në të hyrat e përgjithshme të telefonisë mobile në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

I padituri po ashtu ka deklaruar që objekt ekspertimi nuk kanë qenë të hyrat nga telefonia mobile dhe këto të hyra nuk tregojnë asnjë fakt relevant për kontestin, me ç'rast edhe plotësimi i ekspertizës pa u vërtetuar fakti vendimtar nëse ka pasur anashkalim, është i pabazuar, kundërthënës dhe në kundërshtim me sugjerimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës. Përveç këtyre të metave, ka theksuar që eksperti ka llogaritur fitim të humbur edhe për vitet 2011, 2012 dhe 2013 e të cilat nuk kanë qenë sugjerime nga Gjykata e Apelit, pasi që pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit të Kosovës kishte sugjeruar që nëse vërtetohet baza e kërkesëpadisë me prova juridike, atëherë mendimi i ekspertit duhet të plotësohet duke përfshirë vetëm periudhën 5 mujore deri me datën 10.12.2010.

Më tuje ka theksuar që paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar faktin se e paditura e ka anashkaluar paditësin, si dhe nuk ka bërë sigurimin e provës për të vërtetuar një pretendim të tillë. Ndërsa lidhur me pretendimet e paditësit se e paditura është njoftuar përmes komunikimeve elektronike lidhur me vërejtjet e tyre, ka theksuar që të njëjtat përveç që janë të pabazuara janë edhe kundërthënëse, sepse komunikimet e tilla kanë qenë në frymën e bashkëpunimit me qëllim që paditësit ti mundësohet shitja sa më e madhe e produkteve të paditurës, pasi që ky ka qenë edhe interesi i të paditurës, ndërsa nga raportet e vitit 2009 dhe të vitit 2010 vërehen dallime të mëdha në shitje, ku për vitin 2010 shitjet kanë rënë në mënyrë drastike, ndërsa paditësi nuk ka pasur asnjë vërejtje tek e paditura, lidhur me pretendimet e paraqitura në padi, ndërsa i njëjti

padinë e ka iniciuar vetëm pasi që i padituri në procedurën përmbare ka realizuar borxhin në shumën prej 588,125.00 €.

Sa i përket pretendimeve të paditësit se të njëjtit i takon e drejta në bazë të nenit 124 të LMD-së, ka deklaruar që kjo dispozitë, nuk i jep të drejte paditësit të kërkoj kompensimin e dëmit, por në të kundërtën, i jep të drejte të paditurës, sepse mos përmbushja e kontratës është bërë me fajin e paditësit dhe nga paditësi individualisht dhe se nuk ekziston asnjë ndërhyrje e të paditurës në këtë aspekt. Po ashtu ka theksuar që e paditura ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat ligjore, në momentin kur ka shkëputur kontratën me paditësin, si rrjedhojë e mos përmbushjes së kontratës nga ana e paditësit, përkatësisht me mos përmbushjen e elementit kryesor - substancial të kontratës, që ka të bëjë me furnizimin e dy mijë e gjashtëqind pikave të shitjes, me produktet për të cilat i padituri ia ka ofruar ekskluzivitetin paditësit.

Në fund ka theksuar që e paditura gjatë procedurës gjyqësore ka argumentuar faktin se pas te gjitha vërejtjeve të dërguara tek paditësi dhe pas analizës së blerjeve dhe shitjeve që i ka bërë paditësi, ka ardh në përfundim se paditësi nuk do ta përmbush kontratën dhe ky mos angazhim i paditësit për përmbushje të obligimeve kontraktuale për të cilat ishte zotuar me nënshkrimin e kësaj kontrate, ka ndikuar që e paditura duke vepruar konform dispozitave të nenit 127 dhe 128 të LMD-së, të detyrohet ta zgjidh kontratën para skadimit të afatit.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në shumën prej 4,127.50 €.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 11.07.2024, ka bërë administrimin e provave si në vijim: Ekspertiza financiare e hartuar nga Eksperti financiar V.I., e punuar më datë 21.12.2015 si dhe plotësimin i ekspertizës i datës 28.12.2022; Kontrata “Master Distributor” e lidhur me datën 10.12.2007, ndërmjet palëve ndërgjyqëse se bashku me shtojcën 1 dhe anekset 4, 6 dhe 7; Komunikimet me email, ndërmjet palëve ndërgjyqëse të datës 28.07.2009, 15.07.2009, 12.05.2008, 14.07.2009, 23.09.2009, 16.09.2009, 20.08.2009; Vendimi për ndërprerjen e kontratës, Nr.prot. 152, i datës 01.07.2010; Kartela financiare e paditësit N.T.SH. “GEKOS” si dhe propozimi për lejimin ekzekutimit i datës 08.10.2010.

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata “Master Distributor” e lidhur me datën 10.12.2007, ndërmjet IPKO NET dhe Kompanisë N.T.SH. “GEKOS”, rezulton se IPKO NET i ka dhënë kontraktuesit N.T.SH. “GEKOS”, të drejta jo ekskluzive për shitjen e produkteve në emër dhe për llogari të paditësit për periudhën tre vjeçare nga data e nënshkrimit të kontratës e cila do të vazhdoj të mbetet në fuqi edhe për një afat tre vjeçar, nëse gjatë periudhës deri 90 ditë para kalimit të afatit të saj, palët nuk do të dërgojnë vërejte me shkrim për ndryshimin e kontratës.

Nga Shtojca 1 e Kontratës “Master Distributor të datës 10.12.2007, të lidhur me datën 30.03.2009, palët kontraktuese janë dakorduar që IPKO rezervon të drejtën e ndërprerjes së kontratës me master distributor, pa kurrfarë lajmërimi paraprak, në rast se kontraktuesit bëjnë shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të IPKO-së, në lokacionet për të cilat nuk ka autorizim përkatës nga IPKO. Ndërsa nga aneksi 4, 6 dhe 7 i kontratës, palët janë dakorduar për llogaritjen e përqindjeve dhe për ndryshimin e çmimit të Sim Kartelave.

Nga komunikimet elektronike, rezulton se paditësi me datën 12.05.2008, e ka informuar të paditurin për dy raste ku janë shitur produktet “Fillo”, me çmim prej 4 €, ndërsa mbushjet e vlerës prej 5 € janë shitur me çmim prej 4.86 €. Me datën 14.07.2009 rezulton se palët ndërgjyqëse kanë diskutuar sa i përket targeteve të shitjes, ku paditësi ndër të tjera ka deklaruar që mos përmbushja e targeteve në gjashtëmuorin e parë, e posaçërisht në katër muajt e parë të vitit, ka qenë si reflektim i mospërfilljes së kontratave nga “IPKO dealers” dhe “Gorenje”, duke shprehur interesim për një takim të posaçëm për diskutimin e targeteve të reja të shitjes. Ndërsa nga komunikimi i datës 16.09.2009, rezulton se paditësi e ka informuar të paditurin duke i kërkuar zgjidhje për problemet që janë duke iu krijuar si rezultat i shitjes të mbushjeve të 5 €, me çmim prej 4,74 € dhe 4.75 €, të cilët po destabilizojnë tregun, ndërsa i padituri e ka njoftuar paditësin se lidhur me këtë çështje është lajmëruar menaxhmenti dhe se për çështjet e diskutuara, pritet që të nesërmen të ua kthejnë një përgjigje. Po ashtu nga komunikimi i datës 20.08.2009 rezulton se paditësi e ka njoftuar të paditurin për shitjet e mbushjeve të 5 €, me çmim prej 4,74 € dhe 4.75 €, në rajonin e Ferizajit përveç rajonit të Prishtinës, duke i kërkuar të paditurit që të ndërmerr masa për ndalimin e shitjeve nga të tjerët. Ndërsa nga komunikimi i datës 23.09.2009

rezulton se i padituri ia ka dërguar paditësit pikat të cilat i kanë diskutuar në mbledhjen e po asaj dite, ku janë adresuar çështjet e përgjithshme, marketingu dhe stërshitja.

Nga Vendimi nr. 152 i datës 01.07.2010, rezulton se i padituri ia ka ndërprerë paditësit, kontratën me Master Distributor të lidhur me datën 10.12.2007, për shkak të dështimit të përmbushjes së kushteve të kontratës në gjashtë muajt e fundit. Deri tek shkëputja e kontratës i padituri ka ardhur pasi ka bërë krahasimin e blerjeve të produktit nga paditësi që nga viti i parë i lidhjes së kontratës, ku nga shuma prej 5,000.000.00 €, të produkteve të blera nga paditësi në vitet paraprake, në vitin e 2010 ka rezultuar që paditësi ka blerë produkte në vlerën prej 700,000.00 €, andaj duke qenë se e paditura nuk ka pasur mundësi që të shes direkt në 2600 pikat për të cilat ka pasur ekskluzivitetin paditësi dhe duke marr parasysh që të paditurës i është shkaktuar dëm i madh financiar si rezultat i rënies drastike të shitjeve, paditësit i është komunikuar, se nuk ekziston bazë e shëndoshë për vazhdimin e marrëdhënies kontraktuese në mes tyre.

Nga Ekspertiza Financiare e datës 21.12.2015, e punuar nga eksperti financiar V.I., është konstatuar që nga stërshitjet është shkaktuar destabilizimi në treg duke ia pamundësuar paditësit realizimin e targeteve të shitjes, ndërsa fitimi i humbur i paditësit në rast se nuk do të shkëputej kontrata në mënyrë të njëanshme e ka përcaktuar në vlerën prej 396,062.26 €. Eksperti ka konstatuar që nga tri mënyrat e mundshme të përlllogaritura, ka ardhur në përfundim si në pikën 12 të ekspertizës, ku ka konstatuar që nga dinamika e rritjes së shitjeve nga 10 % për secilin vit, fitimi i humbur për vitin 2010 është në shumën prej 76,805.87 €, për vitin 2011 në shumën prej 84,486.45 €, për vitin 2012 në shumën prej 92,935.10 € dhe për vitin 2013 është në shumën prej 102,228.61 €, ku në total për 4 vite, fitimi i humbur arrin në shumën prej 356,456.03 €, duke ia shtuar edhe vlerën prej 10 % të tatimit në fitim, në shumën totale prej 396,062.26 €. Ndërsa në plotësimin e ekspertizës të datës 28.12.2022 eksperti ka mbetur pranë mendimit dhe konstatimit se vlera e fitimit të humbur arrin në shumën prej 396,062.26 €.

Duke zbatuar sugjerimet e Gjykatës së Apelit të dhëna me Aktvendimin Ae.nr. 292/18 të datës 27.05.2020, gjykata në seancën e datës 11.07.2024 ka dëgjuar ekspertin financiar z. V.I., i cili ka theksuar që nuk ka mundur ti siguroj të dhënat - informatat mbi bazën e regjistrimeve financiare ku prezantohen librat e blerjes dhe shitjes të të paditurës, për vitin 2009 – 2010, pasi që bazuar në legjislaturën tatimore librat e regjistrimit janë të obliguara të ruhen në një afat 6 vjeçar, ndërsa kërkesa për sigurimin e informatave është bërë në vitin 2022. Ndërsa për të arritur

deri te mendimi dhe konstatimi i dhënë si në ekspertizën financiare bazë, eksperti ka deklaruar që ka marr informata nga faqja zyrtare e institucionit mbikëqyrës për operatorët e telefonisë mobile dhe fikse – ART dhe nga këto informata të marra, përkatësisht nga faqja 38 e raportit i cili gjendet në faqen zyrtare të ART-së, plotësimi të ekspertizës i janë bashkëngjitur të gjitha informatat të cilat janë shkëputur nga ky raport, gjë e cila e ka fuqizuar fjalën “nënkuptohe” të përdorur në plotësim të kësaj ekspertize. Po ashtu eksperti ka deklaruar që llogaritjen e fitimit të humbur për vitet 2010 deri në vitin 2013 e ka bërë për shkak të përfshirjes edhe të periudhës ku është paraparë edhe mundësia e vazhimit të kontratës, ndërsa nëse e njëjta do të merret për bazë, ka deklaruar që i bie në vlerësim të gjykatës, duke mbetur pranë konstatimeve të tij, si në pikën 12 të ekspertizës sa i përket përlllogaritjeve të fitimit të humbur nëpër vite.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se paditësi dhe i padituri kanë lidhur kontratë Master Distributor të datës 10.12.2007, ku paditësi në cilësinë e kontraktuesit ka marr përsipër shitjen e produkteve të të paditurit në 2600 pika të shitjes. Në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse kontrata e lidhur me datën 10.12.2007, është shkëputur në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit me datën 01.07.2010 dhe si rrjedhojë nëse përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie në barrë të paditurit, respektivisht nëse ekziston baza ligjore e krijimit të detyrimit dhe kompensimit.

Nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se i padituri në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim ka shkëputur kontratën me paditësin, andaj edhe është krijuar baza ligjore për kompensimin e dëmit të pësuar që ka rezultuar si pasojë e shkëputjes së njëanshme dhe në kundërshtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe dispozitat kontraktuese për arsytet në vijim:

Sipas nenit 1 të Kontratës me Master Distributor të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse të datës 10.12.2007, është përcaktuar që: *“IPKO NET i jep Kontraktuesit të drejta jo ekskluzive për të shitur produkte për dhe në llogari të IPKO NET-i; Kontraktuesi do të ndërmarr veprimet e përshkruara në paragrafin 1.1 të këtij neni vetëm brenda rrjetit të tij (Hiper-Markete, Super-Markete, Mini-Markete, Pompa të Benzinës dhe Kiosqe) dhe do të ketë ekskluzivitet në këto kategori për shitjen e produkteve të IPKO-s në tërë territorin e Kosovës. Po ashtu sipas nën par. 1.6 është përcaktuar që: “Kontraktuesi nuk ka të drejtë të shes ose shpërndaj Produktet e Ipko*

NET-it, në asnjë mënyrë tjetër dhe në asnjë vend tjetër përveç asaj të përshkruar në këtë marrëveshje”.

Me nenin 7 par.1 të kësaj kontrate është përcaktuar afati kohor i kontratës ku palët janë dakorduar që: *“Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe lidhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare dhe e cila automatikisht pas periudhës tre vjeçare do të vazhdoj të jetë në fuqi edhe për një afat tre vjeçar nëse gjatë periudhës deri 90 ditë para kalimit të afatit të saj palët nuk do të dërgojnë vërejtje me shkrim për ndryshimin e kësaj kontrate”,* ndërsa në par. 2 të këtij neni palët janë dakorduar që: *“jo më larg se në 6 (gashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës palët janë të obliguara që të merren vesh për procedurat e garancisë së dyanshme dhe Kushtet e Ndërprerjes së Kontratës”.*

Sipas Shtojcës 1 të Kontratës me Master Distributorë të lidhur me datën 10.12.2007, për sanksionimin e shitjes apo shpërndarjes së produkteve nga kontraktuesi pa autorizim të IPKO-së, palët ndërgjyqëse me datën 30.03.2009, janë pajtuar që IPKO rezervon të drejtën e ndërprerjes së kontratës me master distributorë, pa kurrfarë lajmërimi paraprak, në rast se kontraktuesit bëjnë shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të IPKO-s, në lokacionet për të cilat nuk ka autorizim përkatës nga IPKO.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurit, gjykata iu referua dispozitave ligjore të LMD-së (1978) dhe vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Sipas neneve 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Ndërsa sipas nenit 124 të LMD-së, përcaktohet që: *“Për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e mëpastajmë, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëm”.*

Parimet themelore të së drejtës së detyrimeve të parapara me LMD parashohin se palët në marrëdhëniet detyimore duhet të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të ndershme dhe nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave. Në bazë të këtyre parimeve i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla.

Në rastin konkret me dispozitën e nenit 1.3 të Shtojcës 1 të kontratës, është përcaktuar se i padituri ka të drejtën e ndërprerjes së kontratës pa kurrfarë lajmërimi paraprak, vetëm në rast se paditësi bën shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të IPKO-së, në lokacionet për të cilat nuk ka autorizim përkatës nga i paditur. Duke u bazuar në këtë dispozitë, si dhe nga vet deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, rezulton që ndërprerja e kontratës nga i padituri është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 128 dhe 130 të LMD-së, si dhe dispozitat kontraktuese të sipërcekura, pasi që i padituri sipas vendimit nr.152 të datës 01.07.2010, pa asnjë paralajmërim e ka ndërprerë kontratën nën pretendimin e dështimit të përmbushjes së kushteve të kontratës në gjashtë muajt e fundit, konkretisht të rënies së blerjeve të produktit nga paditësi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret e paditura, nuk iu ka përmbajtur dhe nuk ka shprehur gatishmëri për të vepruar sipas kontratës, duke e ndërprerë njëanshëm kontratën e lartcekur, pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar, rezulton se paditësi e ka paralajmëruar disa herë të paditurin, për shkaqet dhe pengesat të cilat ju kanë shfaqur në realizimin e plotë të targeteve, gjë e cila nuk është kontestuar as nga pala e paditur. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se mos realizimi i targeteve të paditësit të përcaktuara nga i padituri, ka ardhur edhe si pasojë e shitjeve të produkteve nga palët e treta, për të cilat paditësi nuk ka mundur të ndërmarrë asnjë veprim për ti parandaluar.

Duke marrë parasysh faktet e provuara dhe ndërprerjen e kontratës në mënyrë të njëanshme, Gjykata vlerëson se paditësit i takon e drejta në fitimin e humbur për pjesën e mbetur të kontratës deri në përfundimin e periudhës tre vjeçare, përkatësisht deri me datën 10.12.2010.

Për përcaktimin e kompensimit të dëmit, gjykata i është referuar dispozitave të nenit 189 dhe 190 të LMD-së, të cilën parashohin se: *“i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar dhe se dëmi duhet të kompensohet në mënyrë të plotë ashtu që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellët atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues”*, andaj bazuar në këto dispozita, gjykata e aprovoi kërkesën për kompensimin e fitimit të munguar në shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit. Lartësinë e

shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit për fitimin e porealizuar (fitimin e munguar) në shumën prej 76,805.87 €, gjykata e ka përcaktuar në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit V.I., të dhënë në ekspertizën e datës 21.12.2015 dhe plotësimin e saj të datës 28.12.2022, të cilës gjykata ia fali besimin, pasi që ekspertiza ishte bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe për më tepër palët ndërgjyqëse gjatë procedurës të rigjyimit, nuk kanë pasur propozime të reja.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur, se kontrata është ndërprerë sipas ligjit, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime janë të pabazuara, ngase në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet nga neni 1.3 i shtojcës 1 të kontratës, për ndërprerjen e kontratës pa paralajmërim, meqenëse i padituri në këtë mënyrë ka mundur të veproj vetëm në rast se paditësi do të kishte ndërmarrë veprime për shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të paditurit në lokacionet për të cilat nuk ka autorizim përkatës nga i padituri.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e shumës prej 319,256.39 €, në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore prej vitit 2011 deri në vitin 2013, së bashku me kamatën ligjore, për arsyet si në vijim:

Nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se palët kanë lidhur marrëveshjen për një periudhë 3 (tre) vjeçare dhe e cila automatikisht pas periudhës tre vjeçare do të vazhdoj të jetë në fuqi edhe për një afat tre vjeçar nëse gjatë periudhës deri 90 ditë para kalimit të afatit të saj palët nuk do të dërgojnë vërejtje me shkrim për ndryshimin e kësaj kontrate.

Pavarësisht faktit që palët janë dakorduar që vazhdimi i marrëveshjes do të bëhet në mënyrë automatike, në rast se 90 ditë para kalimit të afatit palët nuk dërgojnë vërejtje me shkrim, megjithatë gjykata vlerëson se në rastin konkret, e paditura, sipas vendimit nr. 152 të datës 01.07.2010, paditësit i ka komunikuar, se nuk ekziston bazë e shëndoshë për vazhdimin e marrëdhënies kontraktuese në mes tyre. Prandaj, duke marr për bazë që ndërprerja e kontratës është bërë para skadimit të afatit prej 90 ditëve, përkatësisht me datën 01.07.2010, gjykata vlerësoi se paditësit, nuk i takon e drejta për fitimin e humbur, për periudhën e lartcekur, meqenëse kontrata nuk mund të konsiderohet se është vazhduar dhe ka mbetur në fuqi, pasi që pala e paditur nuk ka shprehur vullnetin për të vazhduar marrëdhënien kontraktuale.

Andaj gjykata vlerëson se, një kërkesë e tillë, bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së detyrimeve, meqenëse palët në marrëdhëniet detyrimore duhet të sillen në mënyrë

të ndërgjegjshme dhe të ndershme ku nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave dhe se i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla. Prandaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerësoi se kërkesa e paditësit, përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nuk gjen mbështetje ligjore dhe si e tillë është e pabazuar.

Gjykata duke iu referuar nenit 277 të LMD-së (1978) i aplikueshëm për detyrimet që kanë lindur para datës 20.12.2012, si dhe Mendimit Juridik për Kamatën nr.265/20 të datës 02.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit të dëmit, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore siç e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë, gjegjësisht nga data 14.06.2013, e deri në pagesën definitive, pasi raporti detyrimor në rastin konkret është krijuar para datës 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit që ti paguaj në mënyrë proporcionale me suksesin e arritur në procedurë, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 325 €, për taksën për padi, shumën prej 500 €, për përfaqësim në 8 seanca të mbajtura shumën prej 2,163.20 € (270.40 x 8), për pagesën e ekspertizës financiare shumën prej 300 €, në emër të përpilimit të dy ankesave shumën prej 416 €, (2x208), si dhe në emër të taksave për ankesë shumën prej 60.00 € (2x30) gjithsej shumën totale prej 3,764.20 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2877/22, datë 11.07.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.